



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1570/4 prot.

Elbasan, me 15.06.2024

VENDIM
Nr. 37, datë 15.06.2024

Për
disa ndryshime në VBA-në nr 51 datë 28.12.2023 "Për ulje tarife vjetore të shkollimit të studentëve në Ciklin e dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2023-2024".

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së Nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, VBA nr 36 datë 06.11.2023 "Për ngritjen e Komisionit "Ad Hoc", Për procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave: Ulje tarife vjetore shkollimi për vitin akademik 2023-2024", VBA-në nr 51 datë 28.12.2023 "Për ulje tarife vjetore të shkollimit të studentëve në Ciklin e dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2023-2024", Relacionit "Për disa ndryshime VBA nr 51 datë 28.12.2023 "Për ulje tarife vjetore të shkollimit të studentëve në Ciklin e dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2023-2024", paraqitur nga Administratori z. Eljan Hoxha, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- 1- Përfitojnë ulje tarife shkollimi 81 studentë me rezultate (mesatare 9-10-të) brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 2- Përfitojnë ulje tarife shkollimi 121 studentë me kritere të tjera mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Nuk përfitojnë ulje tarife shkollimi 15 studentë, nga të cilët 5 studentë me mesatare me program të dytë studimi dhe 10 studentë për arsye të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara, sipas listës bashkëlidhur
- 4- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI I BORDIT
Dr. Ardian Durmishi

